



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 63/1 Prot.

Tiranë, më 7/2/2014

U R D H E R

Nr 03, datë 07/02/2014

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në kuadër të ushtrimit të punës së tij ky Autoritet mbikëqyr në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme informacionet që jepen nga shtypi i shkruar dhe ai audioviziv. Objekt i kësaj mbikëqyrje është mbrojtja e të dhënave personale, jetës private dhe dinjitetit të subjekteve të kronikave të shtypit të shkruar dhe atij audioviziv.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale bazuar edhe në informacionin e datës 09.01.2014 të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) drejtuar Komisionerit, verifikoi ligjshmërinë e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, nga kontrolluesi Televizioni "A1 Report" në publikimin e lajmeve lidhur me dhunimin e një gruaje nga bashkëshorti dhe djali i saj në qytetin e Durrësit dhe vrasjes së 4 personave në qytetin e Korçës.

Kronika lidhur me vrasjen e 4 personave në qytetin e Korçës

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konstaton se televizioni "A1 Report" me datat 07 dhe 08 janar 2014 ka transmetuar kroniken lidhur me vrasjen e 4 personave në qytetin e Korçës. Gjatë transmetimit të kësaj kronike thuhet se... "*një lidhje jashtë martesore dhe tentativat për ta ndaluar atë fshihen pas krimit makabër që ndodhi mbrëmë në fshatin Gjonomadh të Korçës, ku mbeten të vrarë 4 persona*".

Nga kronika jepen informacione të hollësishme lidhur me rrethanat e ngjarjes, jepen emrat dhe mbiemrat e viktimave, lidhjet familjare të tyre, informacione për fëmijët e mbetur jetim, si dhe emri dhe mbiemri i gjyshit të fëmijëve. Në kronikë nuk kemi seleksionimin e informacioneve jo të domosdoshme në një përshkrim të ngjarjes të kryer, në mënyrë që të respektohet privatësia e personave të përfshirë në këtë ngjarje.

Nga kjo kronikë të miturit në fjalë (2 dhe 4 vjeç) përveç faktit të humbjes të dy prindërve njihen nga publiku dhe "*për faktin se motivi i krimit ka qenë nëna e tyre e cila ka pasur një lidhje jashtë martesore me autorin e krimit*". Pavarësisht faktit që nuk përmenden emrat e të miturve, faktet që sjell kronika lidhur me vendin e kryerjes së krimit, emrat e personave të vrarë, emrin e vrasësit dhe përshkrimi me imtësi i deklaramëve të vrasësit, bëjnë të mundur që të dy të miturit të shndërrohen në subjekte të identifikueshëm për këdo që ka ndjekur këtë kronikë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale rikujton se, e drejta e ligjshme për të raportuar fakte me rëndësi publike e ushtruar nga mediat duhet të shoqërohet gjithmonë nga vetëpërmbytja e gazetarëve për të qenë të kujdesshëm në publikimin e fakteve që mund të rëndojnë dhe dëmtojnë viktimat e këtyre ngjarjeve. Kjo përgjegjësi e gazetarit është akoma me e madhe kur kjo ngjarje ka të bëjë me të mitur, të cilët në këtë mënyrë kronika i viktimizon me tej, duke anashkaluar fenomenin, pra thelbin e kronikës dhe duke nxjerr në pah detaje, të cilat nuk ndikojnë në thelbin e asaj që duhet të arrihet nga transmetimi i kronikës.

Transmetimi i kësaj kronike me pohimet e mësipërme përbën një shkelje të rëndë të Kushtetutës së Shqipërisë, Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në udhëzimin nr. 9, datë 15/09/2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive” i ndryshuar, në kreun II pika 4 parashikon që “Me qëllim të mbrojtjes së personalitetit, gazetari nuk publikon emrat e të miturve të përfshirë në raportet e lajmeve apo të japë detaje që mund të çojnë në identifikimin e tyre. Mbrojtja e personalitetit të fëmijës shtrihet, duke pasur parasysh cilësinë e lajmit dhe komponentët e saj, për faktet që nuk përbëjnë në mënyrë specifike krime. Ndalohet publikimi dhe përhapja e detajeve, me çdo mjet, të lajmeve apo fotove për të identifikuar një fëmijë të përfshirë në një krim”.

Gjatë aktivitetit të tyre gazetarët duhet të bëjnë kujdes që të balancojnë nevojat e tyre për përdorimin e informacionit që përmban të dhëna personale me të drejtën e individit për respektimin e privatësisë së tij. Në rastin konkret e drejta e privatësisë së të miturve, është parësore në krahasim me të drejtën e kronikës, kronika nuk duhet të transmetojë informacione të tilla që të bëjë të mundur identifikimin e të miturve viktimat të kësaj ngjarje kriminale.

Kronika lidhur me dhunimin e një gruaje nga bashkëshorti dhe djali i saj në qytetin e Durrësit

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konstaton se nga televizioni “Al Report” me datat 07 dhe 08 janar 2014 është transmetuar kronika lidhur me dhunimin e një gruaje nga bashkëshorti dhe djali i saj në qytetin e Durrësit. Gjatë transmetimit të kësaj kronike thuhet se ...“ 39 vjeçarja nga qyteti i Durrësit e dhunuar psikologjikisht dhe fizikisht nga djali dhe bashkëshorti i saj ka rrëfyer vuajtjen që ka përjetuar. ka rrëfyer çastet e dhunës nga i biri dhe burri i saj. Shkak i kësaj dhune duket se ka qenë dyshimi se 39 vjeçarja kishte një lidhje jashtëmartesore” më tej kronika jep informacione të hollësishme duke përshkruar mënyrën si ka ndodhur ngjarja, veprimet e kryera nga bashkëshorti dhe djali 17 vjeçar i viktimës, si dhe emrin i djalit tjetër minorene të kësaj familje.

Në këtë kronikë viktimat jepet në ekran pa marrë masa mbrojtëse që ajo të mos jetë e identifikueshme, masa këto të cilat do të bënin të mundur që publiku të merrte informacionin e saktë lidhur me këtë ngjarje, pa patur nevojë që kjo grua të identifikohet nga të gjithë ato që kanë parë kroniken si “ajo grua nga Durrësi që e rrahu i shoqi dhe djali dhe i prenë flokët”. Edhe në se ajo ka dhënë pëlqimin e saj për të dhenë intervistën pa

mbrojtur pamjen e saj, ky fakt nuk shkarkon nga përgjegjësia gazetarin e kësaj kronike. Gazetari duhet të mirëkuptojë gjendjen psikike dhe fizike të saj dhe ai vetë duhet të realizonte kroniken duke u kujdesur që viktima e kësaj ngjarje të mos identifikohet nga publiku. Gjithashtu edhe në këtë kronikë kemi të përsëritur shkeljet e të drejtave dhe privatësisë të minoreneve të cilat u trajtuan gjerësisht në rastin e kronikes në qytetin e Korçës.

Është rasti këtu për të përmendur përkufizimin e “pëlqimit” sipas Opinionit të Grupit të Punës Neni 29 të Direktivës 95/46 /EC për mbrojtjen e të dhënave, ku për përkufizimin e “pëlqimit” thuhet se “Marrja e pëlqimit nuk lejon shmangien nga dispozita të tjera. Ai përbën kryesisht një bazë për ligjshmërinë, dhe jo për heqjen dorë (revokimin) nga zbatimi i parimeve të tjera”, pra gazetari duhet të ushtrojë të drejtën e tij për informimin e publikut duke respektuar faktin që nga ana tjetër ndodhen të drejtat e individit për mbrojtjen e jetës private, identitetit, dinjitetit, të drejta dhe vlera të cilat ndikohen drejtpërdrejte nga informacioni që kemi për individin.

Edhe transmetimi i kësaj kronike me pohimet e mësipërme përbën një shkelje të rëndë të Kushtetutës së Shqipërisë, Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në udhëzimin nr. 9, datë 15/09/2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive” i ndryshuar në kreun I pika 8 shprehet se “Gazetari, përveç thelbit të informacionit, nuk jep lajme apo foto publike ose fotografi të njerëzve të përfshirë në ngjarjet që dëmtojnë dinjitetin e personit, nuk ndalet as në detaje të dhunës, përveçse nëse e konsideron lajm ose imazh të interesit publik...”

Përdorimi i të dhënave personale në këtë kronike duhet të kryhet në respekt të të drejtave , dhe lirive themelore të njeriut, si dhe dinjitetit të subjekteve të të dhënave që përfshihen në ngjarje të tilla. Dinjiteti është parametri më i rëndësishëm për vlerësimin e ligjshmërisë të përpunimit të të dhënave personale në fushën e gazetarisë dhe mediave audiovizive, kujtojmë këtu se Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 1 të saj thotë “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm. Ai duhet të respektohet dhe të mbrohet”.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

U R D H E R O J

1. Ndalimin e publikimit të mëtejshëm të të dhënave personale që lidhen me rastin e transmetimit të kronikes mbi vrasjen e 4 personave në qytetin e Korçës, të transmetuar nga televizioni “Al Report”.
2. Fshirjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale të cilat bëjnë të identifikueshëm të miturit e përfshirë në kronikën mbi vrasjen e 4 personave në qytetin e Korçës të transmetuar nga televizioni “Al Report”.

3. Ndalimin e publikimit të mëtejshëm të të dhënave personale që lidhen me rastin e transmetimit të kronikes mbi dhunimin e një gruaje nga bashkëshorti dhe djali i saj në qytetin e Durrësit, të transmetuar nga televizioni "A1 Report".
4. Fshirjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale të cilat bëjnë të identifikueshëm gruan dhe të miturin viktimë të këtij krimi të përfshirë në kronikën mbi dhunimin e një gruaje nga bashkëshorti dhe djali i saj në qytetin e Durrësit, të transmetuar nga televizioni "A1 Report".
5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit.. "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

